



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 67, Datë 02.03.2026

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 46/8 prot., datë 26.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e asetëve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatohet se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Autorizim

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 10 MW, me vendndodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit.
- Me shkresën nr. 2627/2 prot., datë 03.12.2025 shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosje kolateral asetet fikse të të licencuarit, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Fillimi i Procedurës për transferimin e asetëve

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 342, datë 23.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

3. Procedura vijuese dhe Vlerësimi i dokumentacionit

- ERE me e-mailin e datës 30.12.2025 dhe shkresën nr. 2627/5 prot., datë 30.12.2025, njoftoi shoqërinë në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 342/2025 dhe e ftoi në seancën dëgjimore të planifikuar në datën 09.01.2026, seancë e cila, në bazë të kërkesës për shtyrje nga ana e shoqërisë, u mbajt në datë 19.01.2026. Në këtë seancë, shoqërisë iu kërkuar sqarimet përkatëse, në lidhje me kontratat e kredisë të cilat janë nënshkruar përpara licencimit të “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., por nga ana tjetër bëhet me dije se kanë pësuar ndryshime e janë rishikuar në vijim pas licencimit të saj.
- ERE me shkresën nr. 46/6 prot., datë 12.02.2026 ERE ka kërkuar sqarime në lidhje me dokumentacionin e munguar në aplikim.

- Me shkresat nr. 46/5 prot., datë 02.02.2026 dhe nr. 46/7 prot., datë 13.02.2026 shoqëria ka përcjellë dokumentacion/informacion plotësues.
- Nga sa analizuar, nga i gjithë dokumentacioni i përcjellë në kuadër të aplikimit, konstatohet se tre linjat e kredisë, përkatësisht kontrata me nr. 1518 rep., nr. 1122 kol., datë 19.04.2021, me nr. 4152 rep., nr. 3125 kol., datë 13.10.2021 dhe me nr. 4896 rep., nr. 3198 kol., datë 24.08.2022, janë nënshkruar përpara licencimit të shoqërisë nga ERE dhe si e tillë vlerësohet se ERE nuk ka kompetencën për t'u shprehur, për sa kohë detyrimi kontraktor ka lindur përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit. *Ndaj, këto tri kontrata nuk mund të përfshihen në ndjekjen në vazhdim të procedurës së nisur mbi kërkesën e shoqërisë për transferimin e aseteve fikse të saj.*
- Nga ana tjetër, kontrata e kredisë nr. 7316 rep., nr. 3097 kol., datë 02.09.2025, nuk është dhënë me qëllim financimin në veprimtarinë e licencuar nga ERE, atë të prodhimit të energjisë elektrike, ndaj nevojitet të sqarohet/dokumentohet lidhja mes qëllimit të nënshkrimit të kontratës së kredisë (blerje lënde të parë për prodhimin e strukturave metalike për sistemet fotovoltaike) me veprimtarinë e licencuar nga ERE për prodhimin energjisë elektrike, si dhe nevojën për marrjen e një financimi tjetër, pasi nga të dhënat e tregut të energjisë elektrike që disponojmë, rezulton se shoqëria është futur në prodhim që në muajin janar 2023, që nënkupton se centrali tashmë është ndërtuar/financuar. Gjithashtu, si asetet fikse dhe pronat tokë/arë që janë vendosur kolateral për kredinë, janë të njëjtat që sigurojnë detyrimet e kontratave të kredive më lart cituar, pra në rast të mosshlyerjes së detyrimit nga ana e shoqërisë për kontratën e vitit 2025, ndodh ekzekutimi i të gjithë kolateralit edhe pse vlera e kredisë së dhënë është e vogël krahasuar me total asetet (në total prej 738,708,209.91 lekë) të cilat shoqëria i vendos si barrë për të siguruar pagesën e kësaj linje.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së bordit

- Për të gjitha sa më sipër vlerësohet të bëhen sqarimet përkatëse me subjektin kërkues dhe bankën në lidhje me procedurën që ndjek/trajton ERE në kuptim të akteve ligjore dhe nënligjore, ndaj vlerësohet të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim që të bëhen sqarimet përkatëse për sa më sipër cituar dhe zhvillimin e një seance të mundshme dëgjimore me shoqërinë dhe bankën, vlerësohet zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sqarimet/dokumentet përkatëse brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën në lidhje me tre kontratat e kredisë me nr. 1518 rep., nr. 1122 kol., datë 19.04.2021, nr. 4152 rep., nr. 3125 kol., datë 13.10.2021 dhe nr. 4896 rep., nr. 3198 kol., datë 24.08.2022, të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 342, datë 23.12.2025, pasi janë nënshkruar përpara licencimit të shoqërisë nga ERE.

2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., në lidhje me kontratën e kredisë nr. 7316 rep., nr. 3097 kol., datë 02.09.2025.
3. Shoqëria duhet të depozitohet në ERE sqarimet/dokumentet përkatëse brenda 20 (njëzet) ditëve.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. dhe “Raiffeisen Bank” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI